



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

**V E N D I M**

**Nr. 142, Datë 04/10/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 35, datë 04.04.2019, e Znj. P.S., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes politike”, nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesja ka punuar në pozicionin e Kryetares së Degës së Burimeve Njerëzore pranë Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë, që prej datës 11.11.2015. Znj. P.S. shprehet se deri në datën 05.02.2018 ka vijuar punën normalisht, duke patur vlerësim maksimal nga Administratori i kësaj Shoqërie.

Ankuesja pretendon se diskriminimi për shkak të bindjes politike<sup>2</sup> ka filluar menjëherë pas pas emërimit të Znj. Zh.D., në pozicionin e Administratorit të ri të kësaj shoqërie, përkatësisht në datën 05.02.2018. Ankuesja P.S. thekson faktin se është anëtare e subjektit politik LSI, si dhe ka qenë kandidate për deputete në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013, për subjektin politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe njëkohësisht ka mbajtur pozicionin e Zv/kryetarit të Partisë LSI dhe atë të Kryetares së Forumit të Gruas për Qarkun Lezhë. Pikërisht këto fakte, kanë sjellë si pasojë diskriminimin e saj, për bindjet politike, nga Administratorja aktuale e Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë.

---

<sup>1</sup>Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

<sup>2</sup>Referuar Kartës së Anëtarësisë Nr. 79, datë 05.03.2016, të lëshuar nga subjekti politik LSI, rezulton se Znj. P.S., është anëtare e kësaj force politike.

Znj. P.S. pretendon se Administratorja e emëruar rishtazi i ka dhënë urdhëra verbalë për të kryer emërimet për ulje në detyrë të punonjësve me arsim të lartë e për t'i zëvendësuar ata me punonjës me arsim të mesëm.

Njëkohësisht, ankuesja shprehet se Administratorja e Shoqërisë nuk e ka lejuar të përfundojë lejen vjetore të vitit 2017, të cilën për arsye personale, Znj. P.S. kishte planifikuar ta kryente përgjatë datave 15.02.2018-15.03.2018. Për këtë planifikim, ajo pretendon të ketë marrë miratim zyrtar nga Administratori i mëparshëm, i Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë.

Në vijim, Znj. P.S. sqaron se në datën 14.02.2018, Administratorja e Shoqërisë ka tentuar t'i japë masë disiplinore, me motivacion se ankuesja nuk është gjendur në zyrë gjatë orarit të punës, pavarësisht se listë-kontrolli i asaj dite, vërteton të kundërtën. Ajo pretendon se në të njëjtën ditë, Administratorja e Shoqërisë ka miratuar urdhërin, nëpërmjet së cilit është vendosur kryerja e auditimit të brendshëm të Zyrës së Burimeve Njerëzore. Znj. P.S. pretendon se Urdhëri i Auditimit është i paligjshëm, pasi në të nuk janë përcaktuar afatet e auditimit, grupi i auditimit dhe arsyet e auditimit. Ankuesja e ka kundërshtuar urdhërin e sipërpërmendur, nëpërmjet shkresës nr. 018/1 Prot., datë 15.02.2018, por Administratorja e Shoqërisë ka vendosur të kryejë auditimin e zyrës, pavarësisht faktit se Znj. P.S. ishte duke kryer lejen vjetore.

Në vijim, ankuesja e informon Komisionerin mbi faktin se Raporti Përfundimtar i Auditit të Brendshëm Nr. 137, datë 05.03.2018, është në shkelje të ligjit, pasi është kryer, hartuar dhe nënshkruar vetëm nga një specialist. Nga ky raport ka rezultuar se Znj. P.S. ka kryer shkelje, por ankuesja pretendon se ky raport është i pabazuar në prova dhe në fakte dhe si të tillë, ajo e ka kundërshtuar, nëpërmjet shkresës nr. 148, datë 06.03.2018. Kundërshtimi i saj nuk është marrë parasysh dhe në vijim, me Urdhërin nr. 144, datë 06.03.2018, e Administratores së Shoqërisë, ankuesja është ulur në detyrë, nga pozicioni i Kryetares së Degës së Burimeve Njerëzore, në pozicionin e Përgjegjesit të Godinës. Ankuesja sërisht e ka kundërshtuar uljen në detyrë, nëpërmjet shkresës nr. 149, datë 06.03.2018 dhe në vijim nuk është paraqitur më në punë, në detyrën e re, por ka vijuar të ndjekë procedurat ligjore në rrugë gjyqësore.

Ankuesja sqaron se gjatë vitit 2017, Shoqëria “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë, ka qenë subjekt kontrolli nga Kontrolli i Lartë të Shtetit dhe Raporti Përfundimtar i Grupit të Kontrollit të KLSH-së ka rezultuar me vlerësime pozitive ndaj punës së kryer nga Zyra e Burimeve Njerëzore, përveç disa detyrave, që KLSH kishte lënë si rekomandime për periudhën kohore në vijim, për të cilat struktura, ku ankuesja punonte filloi zbatimin e menjëhershëm të tyre.

Znj. P.S. thekson faktin se ulja e saj në detyrë dhe në vijim zgjidhja e kontratës së saj të punës ka ndodhur si pasojë e diskriminimit politik, të ndjekur ndaj saj nga Administratorja aktuale e Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

**A.** Pas analizimit të ankesës nr. 35, datë 04.04.2019, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

**B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>3</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Administratores së Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” nr. 2, me shkresën nr. 537/1, datë 09.04.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

- Kopje e kontratës së punës së ankueses me Shoqërinë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë;
- Kopje e librezës së punës së ankueses;
- Informacion nëse ndaj ankueses janë dhënë masa disiplinore gjatë periudhës, që ka punuar pranë Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë;
- Vlerësime për punën e kryer nga ankuesja ndër vite pranë Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë;
- Kopje e Urdhërit të Auditimit, të vitit 2018, dhe Raportit Përfundimtar të Auditimit ndaj Zyrës së Burimeve Njerëzore, të Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë;
- Kopje e Raportit të Auditimit nr. 770/10, datë 22.11.2017, të kryer nga KLSH, pranë Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë;
- Korrespondenca zyrtare ndërmjet Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë dhe Znj. P.S., nga momenti i miratimit të urdhërit të auditimit e në vijim;
- Kopje të shkresës nr. 012 prot., datë 13.02.2018 dhe shkresës nr. 011 prot., datë 13.02.2018, të Administratores së Shoqërisë;
- Urdhëri i Administratorit të Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë për ulje në detyrë të ankueses P.S.;
- Akti administrativ, nëpërmjet së cilit, janë ndërprerë marrëdhëniet e punës ndërmjet Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Tiranë dhe Znj. P.S..
- Çdo vendim gjyqësor të marrë nga gjykata kompetente, në lidhje me procesin gjyqësor që është zhvilluar ndërmjet Shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2 dhe Znj. P.S..

**1.** Në përgjigje të shkresës nr. 537/1, datë 09.04.2019, të Komisionerit, Shoqëria “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, dërgoi shkresën nr. 537/2, datë 18.04.2019, nëpërmjet së cilës sqarohet se në rastin e Znj. P.S. nuk ka diskriminim për shkak të bindjes politike, por kemi të

---

<sup>3</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

bëjmë me zgjidhje të menjëherëshme të pajustificuar të kontratës nga punëmarrësi, pika 1, neni 156, i Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), ku parashikohet: *“Kur kontrata e punës zgjidhet nga punëdhënësi për arsye se provohet se punëmarrësi nuk paraqitet në vendin e punës, të caktuar në kontratën e punës, ose e braktis atë menjëherë, pa shkaqe të arsyeshme dhe brenda 7 ditëve nuk ka njoftuar me shkrim punëdhënësin, ajo konsiderohet si zgjidhje e pajustificuar e kontratës nga ana e punëmarrësit. Punëmarrësi duhet të përgjigjet financiarisht ndaj punëdhënësit, jo më shumë se paga e një jave. Ai duhet të përgjigjet edhe për dëmin shtesë, që është diferenca midis dëmit dhe pagës së 1 jave”.*

Znj. P.S. është emëruar pranë Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, sh.a. me anë të Urdhërit nr. 410, datë 11.11.2015 të Administratorit të kësaj shoqërie, në funksionin “Kryetare e Degës së Burimeve Njerëzore”. Lidhur me pretendimin e Znj. P.S. se me emërimin e Znj. Zh.D., si titullare e shoqërisë filloi diskriminimi për shkak se ajo ka qene anëtare e subjektit politik LSI, si dhe ka qenë candidate për deputete në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013, kjo shoqëri thekson faktin se një pretendim i tillë është i pavërtetë, pasi ankuesja ka qendruar në detyrë në pozicionin e sipërpërmendur deri në datën 06.03.2018, e në vijim në pozicionin punës Kujdestare e godinës Nr. 1, Inxhinieri, deri në datën 25.04.2018, datë kjo kur i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare, mbështetur në parashikimin e nenit 156, pika 1, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar),

Në lidhje me pretendimin e ankueses se titullarja i ka dhënë urdhëra verbalë, për të kryer ulje në detyrë të punonjësve me arsim të lartë dhe zëvendësim të tyre me punonjës me arsim të mesëm, sqarohet se ulja në detyrë është masë disiplinore që i jepet punonjësit në raste shkeljes disiplinore, gjë që është e parashikuar në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë, si dhe në nenin 12, gërma dh), të Kontratës Individuale të Punës. Për sa i përket uljes në detyrë të kryer me Urdhërin nr.012, datë 13.02.2018, të Znj. F.B., me detyrë përgjegjëse e Sallave të Studimit dhe zëvendësimin e saj nga Znj. E.M., me anë të Urdhërit nr. 11, datë 13.02.2018, të Administratorës, sqarohet se nuk ka anjë shkelje në zëvendësimin e një punonjësi me arsim të lartë me një punonjës me arsim të mesëm, pasi në strukturën e miratuar me Vendimin nr. 63, datë 17.11.2017, kriteri për t’u punësuar për pozicionin e Përgjegjësës së Sallave të Studimit është arsimi i mesëm/i lartë. Ulja në detyrë e Znj. F.B. ka ardhur si rezultat i informacionit të protokolluar me nr. 600, datë 07.02.2018, të dhënë nga Zv/Administratoja e shoqërisë, Znj. A. P., në lidhje me shkelje të përsëritura nga Znj. F.B., për të cilat ka pas qenë vënë në dijeni edhe ish-Administratori i shoqërisë. Në zbatim të Rregullores së Brendshme dhe gërmës dh), neni 12 i Kontratës Individuale të Punës është kryer ulja e saj në detyrë, nëpërmjet Urdhërit nr. 12 ,datë 13.02.2018, urdhër në të cilin është bërë një gabim njerëzor në datë, pasi është protokolluar më një numër më pas se Urdhëri nr. 11, datë 13.02.2018, që ka të bëjë me emërimin në detyrë të Znj. E.M.

Lidhur me pretendimin e ankueses se Administratorja e Shoqërisë nuk e ka lejuar të kryejë lejen vjetore, ky pretendim është i pavërtetë dhe i pabazuar në prova dhe fakte. Me Urdhërin nr. 22, datë 14.02.2018, të Administratores janë anuluar lejet vjetore të prapambetura, të miratuara nga ish-Administratori, deri në një riprogramim të dytë për përcaktimin e datave të fillimit të saj për çdo punonjës, që kishte leje të prapambetur të vitit 2017. Në datat 19 dhe 20 shkurt 2018 është kryer

riprogramimi i tyre nga çdo degë për çdo punonjës, që kishte leje të prapambetur të vitit 2017. Në riprogramimin e kryer, Znj. P.S. ka patur të programuar lejen e prapambetur në datat 15.02.2018 – 15.03.2018. Për sa më sipër, sqarohet se situata e mësipërme ka të bëjë me pezullimin disa ditor të lejeve të prapambetura dhe jo anulim të tyre. Ankueses i është dhënë leja e prapambetur, gje që provohet me kopje të kohëshënuesit për periudhën 01-28 shkurt 2018, muaj në të cilin ajo ka kryer 9 ditë leje respektivisht në datat 20-28.02.2018, si dhe pjesën tjetër e ka kryer gjatë muajit mars 2018, fakt i cili sërisht vërtetohet me formularin e lejeve vjetore, me data 13-31 mars 2018.

Në lidhje me pretendimin se urdhëri për kryerjen e Auditit të Brendshëm është i paligjshëm, pasi në të nuk janë përcaktuar afatet e auditimit, grupi i auditimit dhe arsyet e auditimit, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Nr. 2, e konsideron të pavërtetë. Me emërimin e Administratorit në detyrë është e drejta e tij ligjore të miratojë kryerjen e auditimit të brendshëm të drejtorive, për t’u njohur me gjendjen e institucionit që do drejtojë. Pranë kësaj shoqërie ka funksionuar dhe funksionon Sektori i Auditit të Brendshëm, i cili zbaton detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe të akteve përkatëse nënligjore në zbatim të tij.

Sipas shkresës së dërguar nga Shoqëria “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, Urdhëri nr. 18, datë 14.02.2018, i Administratorit të Shoqërisë, për auditimin e brendshëm të Zyrës së Burimeve Njerëzore ka qenë i miratuar në projekt programin vjetor të Auditit të Brendshëm për vitin 2018, të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës, siç dhe vërtetohet nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës, datë 19.02.2018 ka rezultuar se është vlerësuar që Zyra e Burimeve Njerëzore të auditohet në muajin shkurt 2018. Ankuesja ka kërkuar me shkresën nr. 018/1, datë 15.02.2018, rishikim të kërkesës për auditim të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe në vijim, Administratori me anë të shkresës nr. 36, datë 19.02.2018, pas miratimit të programit vjetor të auditimit të vitit 2018, i ka bërë me dije afatet e auditimit, grupin e auditimit dhe arsyen e auditimit.

Në lidhje me pretendimin e ankueses se Raporti Përfundimtar i Auditit të Brendshëm nr. 137, datë 05.03.2018 është në shkelje të ligjit se është hartuar dhe nënshkruar vetëm nga një specialist, ky pretendim nuk qëndron pasi specialistja e Zyrës së Auditit (sektor, ky, i cili në atë periudhë ka qenë i përbërë nga 2 punonjës, përkatësisht përgjegjësja e sektorit dhe specialistja, në referencë të Strukturës së Shoqërisë, miratuar me Vendimin nr. 63, datë 17.11.2017, të Këshillit Mbikqyrës) në zbatim të Programit të Miratuar nga Këshilli Mbikqyrës në mbledhjen e datës 19.02.2018, ku përcaktohet shprehimisht se është detyrë e Auditit të kryejë auditin e Degës së Burimeve Njerëzore, si dhe të Urdhërit nr. 18, datë 14.02.2018, të Administratorit, ka kryer auditin e brendshëm të Zyrës së Burimeve Njerëzore. Në përfundim të auditimit, në Raportin Përfundimtar nr. 137, datë 05.03.2018, si dhe në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Raport Auditimi i KLSH-së nr. 770/10, datë 22.11.2017, rezultoi se Zyra e Burimeve Njerëzore ka problematika të theksuara dhe ka lënë rekomandime në lidhje me plotësimin e dosjeve të personelit dhe emërimeve të reja, të cilat nuk janë bërë në bazë të meritokracisë. Për sa më sipër, nga Raporti i Auditit rezulton si vijon:

- Janë gjetur shkelje në numrin e punonjësve të shoqërisë, i cili është i tejkaluar nga ai që është i miratuar në Strukturën nr. 63, datë 17.11.2017;

- Punonjësit janë emëruar jo sipas arsimit përkatës, fakt ky i konstatuar edhe ne Raportin Përfundimtar të KLSH-së nr. 770/10, datë 22.11.2017.

Për të gjitha shkeljet e mësipërme, të cilat citohen hollësisht dhe në Raportin e Auditit nr. 137, datë 05.03.2018, të Auditit të Brendshëm, Znj. P.S., në cilësinë e Kryetares së Degës së Burimeve Njerëzore ka patur përgjegjësinë ligjore për këto shkelje. Duke marrë parasysh edhe Rekomandimin Përfundimtar të KLSH-së, për pozicionim të punonjësve në vendet e punës sipas arsimit përkatës, Administratorja mori vendim për uljen në detyrë të Znj. P.S. dhe kalimin e saj në pozicionin e kujdestares së godinës nr. 1, pasi dhe arsimit i lartë, Dega Mësuesi Cikli i Ulët, që ajo ka, është i përshtatshëm me pozicionin e kujdestares së godinës.

Për sa më sipër, në shkresë theksohet fakti se pretendimi i ankueses se ndaj saj janë kryer veprime për shkak të bindjes politike dhe jo për shkak të shkeljeve, të cilat i janë konstatuar duke pasur përgjegjësi të plotë, ligjore për to, është i pabazuar ne prova. Faktet provojnë se në cilësinë e Kryetares së Degës së Burimeve Njerëzore, Znj. P.S. ka patur detyrimin ligjor për të mos lejuar shkeljet, që kanë rezultuar nga Raport Auditit të Brendshëm, si dhe nga Raporti Përfundimtar i KLSH-së nr. 770/10, datë 22.11.2017.

Lidhur me pretendimin e ankueses se kundërshtimi i saj ndaj uljes në detyrë nuk është marrë parasysh nuk qendron, pasi në zbatim të nenit 132 të Kodit të Procedurave Administrative, ankueses i është kthyer përgjigje për të dy ankesat e saj, përkatësisht mbi ankesën nr. 148 dhe ankesën nr. 149, datë 06.03.2018, me shkresën nr. 166, datë 09.03.2018, të Administratorës së Shoqërisë. Përgjigja i është kthyer brenda afateve ligjore, duke i parashtruar edhe shkaqet e mospranimit të ankesës së saj.

Në lidhje me pretendimin e ankueses, se kjo e fundit e ka paditur gjyqësisht shoqërinë, për çështjen e uljes në detyrë, Shoqëria ‘Trajtimi i Studentit ‘ Nr. 2, sqaron se me vendimin nr. 4240, datë 10.05.2018, gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka vendosur kthimin e kërkesëpadisë palës paditëse për të meta thelbësore në paraqitjen e saj.

Në përfundim të shkresës, Shoqëria ‘Trajtimi i Studentit ‘ Nr. 2, shprehet se procesi i largimit nga puna të Znj. P.S. nuk ka të bëjë më asnjë element të karakterit diskriminues për shkak të bindjes politike të ankueses, por është thjesht një zgjidhje e kontratës së punës në mbështetje të parashikimit të pikës 1, nenit 256 të Kodit të Punës dhe nenit 13 të Kontratës Individuale të Punës, pasi Znj. P.S. nuk është paraqitur në vendin e punës, pa shkaqe të arsyeshme dhe nuk ka njoftuar me shkrim brenda 7 ditëve, punëdhënësin, për mungesën e saj. Në këto kushte, ndodhemi para zgjidhjes së pajustificuar të kontratës së punës nga ana e punëmarrësit.

- C. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet **në datën 03.07.2019, ora 12:00**, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesja P.S., me përfaqësuesen e saj ligjore, e cila depozitoi Prokurën e Posaçme nr. 1091 Rep., Nr. 421 Kol., datë 14.05.2019, lëshuar nga notere M. B. Në këtë seancë mori pjesë edhe përfaqësuesja me autorizim e Shoqërisë ‘Trajtimi i Studentit ‘ Nr. 2, e

cila depozitoi Autorizimin nr. 150/3, datë 12.06.2019, të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2, sh.a.

Ankuesja P.S. parashtrori pretendimet saj, si dhe saktësoi faktin se ankesa e saj konsistonte vetëm në lidhje me çështjen e marrjes së masës disiplinore dhe transferimin e saj në pozicionin e kujdestares, në një nga godinat në administrim të Shoqërisë Trajtimi i Studentit “ Nr. 2, por jo mbi çështjen e largimit nga puna. Pas kryerjes së këtij sqarimi, përfaqësuesit e Komisionerit të pranishëm në seancë e fokusuan vëmendjen dhe debatin, vetëm mbi çështjen e theksuar nga ankuesja, e cila u saktësua se përbënte objektin e ankesës së saj.

Në vijim, Znj. P.S. sqaroi faktin se me emërimin e Znj. Zh.D., në cilësinë e titullares së Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” nr. 2, asaj i është tentuar t’i jepet masë disiplinore në datën 14.02.2018. Ajo u shpreh gjithashtu se nuk është lejuar të kryente lejen vjetore të mbetur të vitit 2017, në periudhën, në të cilën e ajo e kishte planifikuar dhe e kishte miratuar ish-Administratori i kësaj shoqërie, si dhe sqaroi se Administratoja aktuale kishte kryer 16 lëvizje punonjësish me urdhëra verbalë.

E pyetur nëse kishte përshkrime të mirëfillta pune për punonjësit e kësaj shoqërie, ankuesja sqaroi se këto përshkrime kanë qenë pjesë e rregullores së brendshme të shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr. 2 dhe se ajo është përpjekur që emërimet e punonjësve të kryhen në mënyrën më të mirë të mundshme nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Lidhur me përshkrimin e punës, të pozicionit, të cilin ankuesja ka mbajtur pranë kësaj shoqërie dhe me kriterin arsimor që përcaktonte ky përshkrim, Znj. P.S. u përgjigj se kriteri arsimor ka qenë “arsim i lartë” pa e përcaktuar profilin arsimor. Një gjë e tillë vihet re në strukturën organike të vitit 2017 për këtë shoqëri.

E pyetur nëse edhe lejet vjetore të punonjësve të tjerë ishin pezulluar nga Administratorja e re e shoqërisë, sikurse leja e ankueses, kjo e fundit u përgjigj se nuk kishte dijeni mbi një fakt të tillë.

Përfaqësuesja e Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr 2, Tiranë u shpreh se ankuesja në asnjë rast nuk është diskriminuar për shkak të bindjes së saj politike. Pezullimi i lejes vjetore të vitit 2017 është kryer për të gjithë punonjësit e shoqërisë, pasi është bërë një riprogramim i tyre. Lejet vjetore nuk u anuluan, por u riprogramuan dhe në vijim të gjithë punonjësit e kryen lejen e mbetur të vitit 2017, në fillim të vitit 2018. Përfaqësuesja e shoqërisë paraqiti në cilësinë e provës listën e lejeve vjetore 2017 të punonjësve të shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr. 2 për periudhën 01-31.03.2018, nga e cila rezultoi se Znj. P.S. i është dhënë leja e mbetur e vitit 2017, të cilën e ka kryer deri në fund. Në cilësinë e provës, nga shoqëria “Trajtimi i Studentit” Nr. 2 u depozitua shkresa nr. 82/2 Prot., datë 08.05.2019, për të provuar se të gjithë personat e listuar në këtë shkresë vazhdojnë marrëdhëniet e punës, pavarësisht se janë anëtarë të një force politike të caktuar, të ndryshme nga ajo në pushtet. Ulja në detyrë e Znj. P.S. ka ndodhur pasi profili i arsimimit të saj “mësuese e ciklit të ulët” nuk përshtatej me pozicionin Kryetare e Degës së Burimeve Njerëzore, si dhe për shkak të disa problematikave që ankuesja ka paraqitur gjatë ushtrimit të detyrës së kryetares së burimeve njerëzore pranë kësaj shoqërie. Përshkrimi aktual i punës për Kryetarin e Burimeve Njerëzore të shoqërisë përcakton se arsimi duhet të jetë jurist

ose ekonomist, ndërkohë që ankuesja është mësuese e ciklit të ulët. Përfaqësuesja e shoqërisë “Trajtimi i Studentit”, Nr. 2, sqaroi se aktualisht janë hartuar dhe miratuar përshkrimet e punës për të gjithë punonjësit e kësaj shoqërie. Njëkohësisht, theksoi faktin se problematikat gjatë ushtrimit të detyrës së ankueses ishin konstatuar në Raportin e KLSH-së. Përfaqësuesi i KMD-së kërkoi informacion nga përfaqësuesja e Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, mbi numrin e punonjësve të shoqërisë që janë larguar nga puna dhe numrin e punonjësve që janë ulur në detyrë nga momenti i emërimit të Znj. Zh.D., në pozicionin e Administratores pranë kësaj shoqërie. Përfaqësuesja e kësaj shoqërie u shpreh se informacioni do të dërgohej zyrtarisht në vijim të seancës dëgjimore.

Përfaqësuesi i KMD-së kërkoi sqarime në vijim nga ankuesja në lidhje me konstatimet e KLSH-së në Raportin e Auditimit, pas kryerjes së auditit pranë Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, Tiranë. Lidhur me numrin mbi organikë të punonjësve të emëruar pranë kësaj shoqërie nga ish-Administratori, shkelje kjo që përbën edhe njërin prej konstatimeve të KLSH-së, ankuesja u shpreh se në momentin e emërimit të saj në detyrën e Kryetares së Burimeve Njerëzore pranë kësaj shoqërie, ky numër ishte tepër i madh, por që ajo ishte përpjekur ta ulte në mënyrë graduale, duke përfshirë këtu edhe pozicionet vakante të punonjësve që dilnin në pension. Përfaqësuesi i KMD-së e pyeti ankuesen, nëse e kishte bërë me dije ish-administratorin e shoqërisë mbi faktin, që ishte tejkalluar numri i punonjësve të përcaktuar në organikë dhe se ky numër ishte i konsiderueshëm, ankuesja u shpreh se në fillim të vitit 2016, ajo ka bërë një raport me shkrim, në lidhje me nevojat e paplotësuara të punonjësve si p.sh. plotësimi i dosjeve personale. E pyetur, nëse lidhur me padrejtësitë e pretenduara ndaj saj, i është drejtuar gjykatës kompetente, ankuesja u shpreh se lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës i është drejtuar gjykatës, ndërkohë që përfaqësuesja e Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, ndërhyri duke shtuar faktin se padia e saj është kthyer mbrapsht nga gjykata, pasi është konstatuar me të meta thelbësore dhe nuk është ridedepozituar në gjykatë.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Shoqëria “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, Tiranë, dërgoi shkresën nr. 150/4, datë 05.08.2019, ku informon hollësisht mbi disa prej çështjeve të diskutuara në seancën dëgjimore të zhvilluar pranë KMD-së.
1. Në lidhje me informacionin e kërkuar mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve, që janë ulur në detyrë ose lëvizur nga pozicioni i punës që prej momentit të emërimit të Znj. Zh.D., në pozicionin e Administratores së Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, Shoqëria sqaron se:  
*“...ndryshimi i pozicionit të punës së punonjësve apo ulja në detyrë është bërë duke marrë parasysh Rekomandimet e Raportit Përfundimtar të KLSH-së nr. 770/10, datë 22.11.2017 dhe pas miratimit të Strukturës nr. 76, datë 27.04.2018, si dhe performancat e tyre në punë, për të bërë të mundur përshtatjen sa më të mirë të punonjësve sipas arsimit përkatës në pozicionet që u përshtatet ky arsim.*
  - *4 punonjës janë lëvizur në detyrë (ulje ose ngritje) në muajin shkurt 2018, duke u bazuar në Raportin Përfundimtar të KLSH-së nr. 770/10, datë 22.11.2017;*



- *15 punonjës kanë ndryshuar pozicionin e punës, për shkak të miratimit të Strukturës nr. 76, datë 27.04.2018, si shkak i ndryshimit dhe të disa funksioneve.*
  - *12 punonjës janë lëvizur në detyrë, si rrjedhojë e kërkesave të tyre, masa disiplinore për moskryerje detyrash, si dhe pozicionim sa më i mirë të punonjësve sipas arsimit profesional të tyre me pozicionin e punës, kur këto vende kanë qenë të lira.”*
2. Lidhur me numrin e punonjësve që janë larguar me procedurë, braktisur vendi i punës, kanë dalë në pension, kanë dhënë dorëheqje dhe u është suprimuar vendi i punës që nga emërimi i Administratores së re, sqarohet si më poshtë:
- *Numri i punonjësve që kanë braktisur vendin e punës është 6 (gjashtë);*
  - *Numri i punonjësve që u është zgjidhur kontrata e punës me procedurë 4 (katër);*
  - *Numri i punonjësve që u ka përfunduar kontrata e punës dhe nuk është rinovuar 1 (një);*
  - *Numri i punonjësve që janë larguar me dëshirën e tyre është 23 (njëzet e tre);*
  - *Numri punonjësve që kanë dalë në pension është 13 (trembëdhjetë);*
  - *Numri i punonjësve që u është suprimuar vendi i punës me miratimin e Strukturës nr. 76, datë 27.04.2018 është 14 (katërmbëdhjetë).*
3. Në lidhje me faktin, nëse ekziston një dokument me shkrim që është përgatitur në lidhje me masat që janë marrë për të pozicionuar punonjësit sipas arsimit përkatës, duke u bazuar në Raportin Përfundimtar të KLSH-së nr. 770/10, datë 22.11.2017, sqarohet se: *“Në zbatim të rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të KLSH-së filloi marrja e masave dhe nuk ka nevojë të përgatitet dokument për lëvizjen e punonjësve pasi vetë vendimet e lëvizjeve janë dokument ligjor që shoqëria ka filluar të zbatojë këto rekomandime, ashtu sic është bërë me masat disiplinore të marra për punonjësit, të cilët janë kapur me shkelje në prokurime publike apo me dokumente finaciare, që duheshin rregulluar të cilët kanë patur mangësi apo me hartim kërkesë padive ndaj subjekteve kontraktues nga prokurimet publike të cilët kanë shkelur këto kontrata”.*

Bashkëlidhur shkresës së Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” nr. 2, Tiranë, është dërguar dokumentacioni i kërkuar nga Komisioneri.

2. Në vijim të seancës dëgjimore, ankuesja P.S. dërgoi shkresën nr. 137, datë 12.09.2019, nëpërmjet së cilës e sërish thekson faktin, se është larguar nga detyra nga administratorja e Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, për shkak të bindjeve të saj politike. Ajo shprehet se në zbatim të rekomandimeve të lëna në Raportin e KLSH-së, kishin filluar të bëheshin largime nga puna për punonjësit e shoqërisë që ishin emëruar mbi organikën e saj, pa u emëruar ende Administratorja e re. Njëkohësisht, ajo shprehet se i është mohuar e drejta për të marrë lejen e mbetur të vitit 2017, në momentin, kur ajo kishte nevojë, pasi babai i saj ishte i sëmurë rëndë dhe kishte nevojë për shërbimet e saj.

Bashkëlidhur shkresës së ankueses u dërguan:

- Shkresa nr. 134, datë 02.03.2018 e ankueses drejtuar Administratores Zh.D.;
- Diplomë nr. 69818, datë 14.10.2000, të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, lëshuar nga Fakulteti i Mësuesisë, Cikli i Ulët, nëpërmjet së cilës Znj. P.S. fiton titullin “Mësuese për Kl. I-IV, të shkollës 8 Vjeçare”;
- Dëshmi e Shoqatës së Invalidëve të Shqipërisë ku rezulton se Z. Z. P.S. ka qenë invalid i grupit të I-rë.
- Kërkesë nr. 168, datë 12.03.2018, e ankueses drejtuar Znj. Zh.D.:
- Shkresë nr. 148/2, datë 16.04.2019, e Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 sh.a. drejtuar ankueses.
- Shkresa nr. 021, datë 24.02.2018, e Znj. P.S. drejtuar Administratores Zh.D..
- Shkresë nr. 155, datë 08.03.2018, e ankueses P.S. drejtuar Komisionit të Disiplinës dhe për dijeni Znj. Zh.D..
- Çertifikatë familjare e ankueses;
- Kopje e formularit të lejes së ankueses, datë 15.01.2018;

#### **I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës nr. 35, datë 04.04.2019, së Znj. P.S., KMD ka marrë në shqyrtim vetëm çështjen, që ka të bëjë me lëvizjen e saj në detyrë, sikurse ankuesja deklaroi gjatë seancës dëgjimore të datës 03.04.2019.

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses.**

##### **A/1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses, si pasojë e lëvizjes në detyrë.**

Znj. P.S. është emëruar në pozicionin e Kryetares së Degës së Burimeve Njerëzore nëpërmjet Urdhërit nr. 410, datë 11.11.2015, të Administratorit të Shoqërisë “Trajtim Studenti nr. 2 sh.a.”. Në vijim të Urdhërit të mësipërm, në datën 12.02.2016, ndërmjet palëve është lidhur Kontrata Individuale e Punës.

Në muajin shkurt 2018, në pozicionin e Administratores së Shoqërisë “Trajtim Studenti nr. 2 sh.a.” emërohet Znj. Zh.D.. Ankuesja pretendon se diskriminimi i saj për bindjet politike e ka filluesën menjëherë me emërimin në detyrë të Administratores së re. Nëpërmjet Vendimit nr. 144, datë 06.03.2018, “Për lëvizje në detyrë”, të Administratores së kësaj shoqërie, ankuesja ka kaluar nga pozicioni i Kryetares së Degës së Burimeve Njerëzore, në pozicionin e Përgjegjës së Godinës Nr. 1, Sektori Inxhinieri. Për sa më sipër, ankuesja pretendon se një veprim i tillë i

ndërmarrë ndaj saj përbën diskriminim, për shkak të bindjes së saj politike, pasi ankuesja është anëtare e forcës politike LSI. Ndërkohë që, Shoqëria “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, e ka justifikuar levizjen në detyrë të ankueses, duke sqaruar se një lëvizje e tillë është kryer si pasojë e shkeljeve të konstatuara në Raportin nr. 137, datë 05.03.2018, e Auditit të Brendshëm të Shoqërisë, ku Znj. P.S., në cilësinë e Kryetares së Degës së Burimeve Njerëzore ka patur përgjegjësinë ligjore për këto shkelje. Njëkohësisht, kjo shoqëri ka theksuar faktin se një lëvizje e tillë është kryer edhe duke marrë parasysh Rekomandimin Përfundimtar të KLSH-së, për pozicionim të punonjësve në vendet e punës sipas arsimit përkatës. Administratori mori vendim për uljen në detyrë të Znj. P.S. dhe kalimin e saj në pozicionin e kujdestares së godinës nr. 1, pasi dhe arsimit i lartë, Dega Mësuesi Cikli i Ulët, që ajo ka, është i përshtatshëm me pozicionin e kujdestares së godinës.

Për sa më sipër, nenet 13-16 të Rregullores së Brendshme të Shoqërisë nr. 127, datë 11.04.2017 “*Për organizimin dhe funksionimin e Shoqërisë Trajtimi i Studentëve Nr. 2*”<sup>4</sup> kanë parashikime, lidhur me rolin, detyrat e funksionet e Degës së Burimeve Njerëzore. Neni 13, i Rregullores përcakton strukturën e këtij sektori, neni 14 i saj, përcakton rolin kryesor të Degës së Burimeve Njerëzore<sup>5</sup> dhe neni 15 përcakton Menaxhimin e Burimeve Njerëzore<sup>6</sup>.

Neni 16, i Rregullores së Brendshme të Shoqërisë nr. 127, datë 11.04.2017, “*Për organizimin dhe funksionimin e shoqërisë Trajtimi i Studentëve Nr. 2*” parashikon shprehimisht: “16.1 Dega e Burimeve Njerëzore zbaton me korrektësi organikën, duke siguruar numrin e punonjësve dhe emërtesën e tyre, duke mos lejuar të shkelet organika e miratuar në Këshillin Mbikqyrës”.

Gjithashtu vlen të përmendet fakti se neni 17, i Kreut III “Seleksionimi dhe Punësimi”, të Rregullores së mësipërme përcakton shprehimisht kriteret e përgjithshme që duhen ndjekur për punësimin e punonjësve në këtë shoqëri, të cilat janë: të jetë shtetas shqiptar, të ketë nivel arsimor në përputhje me kërkesat dhe përshkrimin e vendit të punës, të ketë zotësi të plotë për të vepruar, të zotërojë aftësi të nevojshme profesionale për vendin e punës etj.

<sup>4</sup>Kjo rregullore aktualisht nuk është në fuqi pasi në qershor të vitit 2018, nëpërmjet Vendimit nr. 81, datë 27.06.2018, është miratuar Rregullorja e re e Brendshme e Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2, Sh.a.

<sup>5</sup>Neni 14, i Rregullores së Brendshme të Shoqërisë nr. 127, datë 11.04.2017, “*Për organizimin dhe funksionimin e shoqërisë Trajtimi i Studentëve Nr. 2*” parashikon: “Roli kryesor i Degës së Burimeve Njerëzore është rritja kualifikuese dhe përsosja në organizimin e strukturave për përmirësimin e vazhdueshëm dhe funksional të Shoqërisë: Trajtimi i Studentëve nr. 2” sh.a. me anë të masave si: 14.1. Qartësimi i misionit, përcaktimi i detyrave të çdo punonjësi duke mundësuar vlerësimin objektiv të performancës (përsosjes) individuale. 14.2 Zgjerimi i aktiviteteve trajnuese dhe formave të tjera që rrisin kapacitetet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. 14.3 Lidhja e përshtatshme midis motivimit, shpërblimeve dhe marrjes së masave të ndryshme dhe nivelit të vlerësimit të punonjësve. 14.4 Garantimi i zbatimit të ligjit nr. 9367, datë 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, (i ndryshuar). 14.5 Menaxhimi me efikasitet dhe sigurimi i raporteve të drejta ndërmjet kategorive të caktuara në punonjësve në lidhje me shpërblimin e punës së kryer.”

<sup>6</sup>Neni 15, i Rregullores së Brendshme të Shoqërisë nr. 127, datë 11.04.2017, “*Për organizimin dhe funksionimin e shoqërisë Trajtimi i Studentëve Nr. 2*” parashikon: “15.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore realizohet duke zbatuar një politikë të drejtë e të argumentuar punësimi në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar). 15.2 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore realizohet nëpërmjet lëvizjeve të brendshme, ngritjeve ose uljeve në detyrë dhe plotësimin e vendeve të lira të punës, duke propozuar të Administratori persona të aftë në nivel arsimor në përputhje me përshkrimin e detajuar për çdo vend pune, kur i kërkohet nga Administratori”.

Referuar Vendimit nr. 63, datë 17.11.2017, të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, nëpërmjet së cilit është miratuar Struktura e Shoqërisë për vitin 2018, rezulton se ky vendim parashikon në tërësi nivelin e arsimit (i lartë ose i mesëm) për secilin pozicion pune, pa kryer profilizimin përkatës arsimor të këtyre pozicioneve.

Në Raportin Përfundimtar të KLSH-së nr. 770/10, datë 22.11.2017, që ka lidhje me auditimin e kësaj shoqërie janë konstatuar disa mangësi dhe shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, Lidhur me çështjet që i përkasin Burimeve Njerëzore, të Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, grupi auditues i KLSH-së ka dhënë rekomandimin e mëposhtëm:

- *“Drejtorja e Shoqërisë dhe Këshilli Mbikqyrës të marrë masa për rishikimin e strukturës organizative, për përshtatjen e vendeve të punës sipas profesioneve, si dhe duke shmangur dublimet e detyrave të punonjësve dhe punësimet e panevojshme; (brenda vitit 2017).”*

Për sa më sipër, rezulton se në zbatim të parashikimeve të rregullores së mësipërme, ka qenë detyrë e Zyrës së Burimeve Njerëzore të Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, Tiranë, që duke patur si referencë Vendimin nr. 63, datë 17.11.2017, e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, të përcaktonte profilet e punonjësve sipas pozicioneve tyre të punës, si dhe të moslejonte tejkalimin e numrit organik të punonjësve. Një gjë e tillë rezulton të mos jetë kryer nga ana e Degës së Burimeve Njerëzore, as brenda afatit të përcaktuar në Rekomadim dhe as tej këtij afati. Në kushtet kur, kryetare e kësaj dege ka qenë Znj. P.S., është konsideruar përgjegjësi e saj moskryerja e kësaj detyre, e cila në vijim rezultoi si e pakryer edhe në Raportin e Auditimit të Brendshëm, të kryer në fillim të vitit 2018.

Sikurse u përmend më sipër, në vijim të auditimit të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në bazë të Urdhërit nr. 018, datë 14.02.2018, të Administratores së shoqërisë është kryer audit i brendshëm për degën e Burimeve Njerëzore. Referuar urdhërit në fjalë, objekt auditit janë dosjet e personelit të shoqërisë. Audit i Brendshëm i Zyrës së Burimeve Njerëzore rezulton të jetë i parashikuar në Programin Vjetor të Auditit të Brendshëm për vitin 2018, miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve nr. 2” sh.a.<sup>7</sup>

Në Raport Auditin e Brendshëm nr. 137, datë 05.03.2018, janë konstatuar disa parregullsi në Degën e Burimeve Njerëzore, të cilat në mënyrë të përmbledhur konsistojnë si më poshtë vijon:

- Janë gjetur shkelje në numrin e punonjësve të shoqërisë, i cili është i tejkaluar nga ai që është i miratuar në Strukturën nr. 63, datë 17.11.2017;
- Punonjësit nuk janë emëruar sipas arsimit përkatës, fakt ky i konstatuar edhe në Raportin Përfundimtar të KLSH-së nr. 770/10, datë 22.11.2017.

Ankuesja P.S. ka qenë kundër kryerjes së një auditit të tillë dhe i ka kontestuar zyrtarisht përfundimet e tij. Administratorja e Shoqërisë i ka kthyer përgjigje kontestimit të Znj. P.S., si

---

<sup>7</sup> Audit i Degës së Burimeve Njerëzore është parashikuar të kryhen në muajin shkurt 2018.

dhe ka miratuar Urdhërin e lëvizjes në detyrë, i cili nuk është ankimuar asnjëherë gjyqësisht nga ankuesja.

Për sa më sipër, mbështetur në korrespondencën zyrtare me Shoqërinë “Trajtimi i Studentit” Nr.2, si dhe provave të depozituara gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri gjykon se lëvizja në detyrë e Znj. P.S. nga pozicioni i Kryetares së Degës së Burimeve Njerëzore në detyrën e Kujdestares së godinës Nr. 1, Inxhinieri, ka patur lidhje të drejtpërdrejtë me shkeljet e konstatuara në Raportin e KLSH-së dhe në Raportin e Auditit të Brendshëm.

Lidhur me çështjen e përshtatjes ose jo të arsimit të Znj. P.S. me pozicionin e punës së Kryetares së Degës së Burimeve Njerëzore, Komisioneri gjykon se Shoqëria “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, ka vendosur në vijim kritere të mirëpërcaktuara për të rritur profesionalizmin e drejtuesit të kësaj strukture, duke kërkuar që kriteri arsimor të jetë ekonomist ose jurist, kjo edhe duke gjykuar edhe për analogji të parashikimeve të nenit 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, (i ndryshuar) i cili zbatohet për pozicionet respektive të punës në administratën publike.

Njëkohësisht, gjatë korrespondencës zyrtare me Komisionerin, Shoqëria “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, Tiranë ka dërguar gjithashtu evidenca të një sërë lëvizjeve të punonjësve të saj, të cilat i ka kategorizuar, si më poshtë:

- 4 punonjës janë lëvizur në detyrë (ulje ose ngritje) në muajin shkurt 2018, duke u bazuar në Raportin Përfundimtar të KLSH-së nr. 770/10, datë 22.11.2017;
- 12 punonjës janë lëvizur në detyrë, si rrjedhojë e kërkesave të tyre, masa disiplinore për moskryerje detyrash, si dhe pozicionim sa më i mirë të punonjësve sipas arsimit profesional të tyre me pozicionin e punës, kur këto vende kanë qenë të lira.”

Në këtë kontekst, kjo shoqëri ka provuar se Znj. P.S. nuk është trajtuar në mënyrë të diferencuar, nga pjesa tjetër e punonjësve të kësaj shoqërie, të cilët janë ndodhur në kushte të njëjta ose të ngjashme.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se Znj. P.S. nuk është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentit” Nr. 2, Tiranë, si pasojë e lëvizjes në detyrë nga pozicioni i Kryetares së Degës së Burimeve Njerëzore në detyrën e Kujdestares së godinës Nr. 1, Inxhinieri.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të Znj. P.S., për shkak të bindjes politike, nga Shoqëria “Trajtimi i Studentit” Nr. 2.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**Robert GAJDA**

**KOMISIONER**

**Në mungesë dhe me porosi,  
DREJTORE JURIDIKE**

**Ardiana HALA**

Fusha – punesim  
Shkak – bindja politike